



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel:038/20043814

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY
ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 25-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 29.01.2020 (e mërkurë), në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 14. Misin Berisha, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 15. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 16. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 17. Labinot Aliaj, PDK; |
| 5. Njomza Demaj, LDK; | 18. Arben Kabashi, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 19. Ajshe Metaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 20. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 8. Riza Dreshaj, LDK; | 21. Agron Avdijaj, VV; |
| 9. Ruzhdi Metaj, LDK; | 22. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 10. Valbona Demaj, LDK; | 23. Arif Elshani, IQ; |
| 11. Edona Lubeniqi, LDK; | 24. Radenko Belošević, RB dhe |
| 12. Naim Imeraj, AAK; | 25. Slaviša Maliković, SM. |
| 13. Nexhmedin Balaj, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në të ishin të pranishëm edhe Kryetari Haki Rugova, drejtorë të drejtorive të komunës, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj, (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhirimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z.Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit, hapi punimet për mbledhjen e 25-të të rregullt, të Legjislacionit të VI-të dhe për këtë mbledhje propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i Raportit të Kuvendit Komunal për vitin 2019;
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së KKS-së për vitin 2019;
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2019;
6. Shqyrtimi i Raportit financiar për tre mujorin e katër, Tetor-Dhjetor 2019 dhe
7. Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi, atëherë a ka dikush diçka rreth rendit të ditës? Fjalën e ka kërkuar Labinot Aliaj.

Labinot Aliaj, përshëndeti të pranishmit. Sot në mbledhjen e parë për vitin 2020, kam pritur që pikë e rendit të ditës të jetë në diskutim: "Marrëveshja e komunës së Istogut dhe pronarit të parcelës në pjesën veri-perëndimore të stadiumit". Kam pritur të jetë një lloj marrëveshje në mes komunës dhe dihet së ndërtimi është në pronë private. Si pikë të tetë të rendit të ditës kërkoj të futet dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Kulturës të jepet një raport, ose i urbanizmit, inspektoratit ose kush të dojë. Si është e mundur të bëhet një investim i komunës në pronë private pa u bërë shpronësimi i saj ose pa ardhur ndonjë marrëveshje në kuvend komunal?

Kryesuesi, kjo pikë nuk është e paraparë për rend ditë dhe propozimi që ju bëni, mendoj se nuk është pikë e rendit të ditës urgjente. Zakonisht kur propozohet duhet të jetë një pikë e rendit të ditës që është më urgjente. Mund të jetë në mbledhjen e ardhshme. Mund të bëhet si pyetje dhe sqarim në pikën e fundit të rendit të ditës. Përndryshe si pikë të rendit të ditës pa material nuk bënë ta fusim.

Labinot Aliaj, unë mendoj së në bazë të rregullores me jepet e drejta e propozimit, unë e kam propozu? Ju mund ta hedhni në votim, votohet ose jo.

Kryesuesi, këtë pikë mund të bësh pyetje dhe të marrësh përgjigje atë çka është e mundur në pikën e shtatë. Dikush tjetër a ka diçka? Fjalën ja kaloi Arben Kabashit.

Arben Kabashi, secili anëtar i kuvendit ka të drejt të kërkojë një pikë për diskutim, a ka material a nuk ka, nuk është problem? Mundesh me pas edhe në mbledhjen e ardhshme, thjeshtë Labinot Aliaj ka kërkuar që të diskutohet kjo temë.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Naim Imeraj.

Naim Imeraj, faleminderit për fjalën. Unë kisha një shqetësim tjetër që mund të duket jo si me peshë të madhe por ka qenë shkaku që si anëtar të këtij kuvendi e ndërlidhur me rregulloren e punës së këtij kuvendi për vonesën e materialit që është bërë këtë seancë. Mund të jetë që është e arsyetueshme por realisht edhe ne e kemi një pozicion për të cilin duhet dhe besoj, që nuk është e rendit ajo edhe nuk është e arsyetueshme. Kështu që ju kisha lutë që të sqarohet se pse ka qenë materiali me vonesë edhe ashtu kështu ne gjithmonë po e shkelim atë rregullore. Në rregullore është shtatë ditë punë se paku të jetë brenda një shtatë ditshi cilido çoftë ai.

Kryesuesi, kërkoj falje Naim, ke të drejtë së është dashur që në fillim por nuk mu kujtua. Materiali ka ardhur më vonesë një ditë ngase kjo mbledhje ka qenë e planifikuar me datë 30 ose 31. Për shkak të dy datave të rëndësishme 31 Janari: "Dita e Dëshmorëve të Shkollës Shqipe" në Uçë dhe 30 Janari: "Dita e vdekjes së ish kryetarit të komunës tonë Fadil Feratit". Për këtë arsye ka qenë kjo me vonesë.

Kryetari, faleminderit për fjalën. Një çështje që unë duhet të flas këtu ose të jap përgjigje. Kërkohet një pikë e rendit të ditës ad hok, pyetja imë është çka të diskutohet? Nëse ki diçka për diskutim atëherë urdhëro menjëherë e ke fjalën? Aty çdo gjë është në rregull, unë e di që çështjen e pronarit, i di pronat dhe këtu ka pasur marrëveshje paraprake kur ka qenë një shpronësim më herët. Pronari e ka blerë atë truall dhe unë kam qenë këtu kur kanë filluar punimet, ata kanë lejuar të bëhet ndërtimi dhe askush me sherr nuk është duke e bërë. Mos të krijohet përshtypje se ka një sekret që t'i po mundohesh me zbulu dhe të mbesim ne në lajthitje. Aty nuk ka asgjë Labinot dhe je më i vogël që t'i mbrosh interesat e asaj kompanie.

Labinot Aliaj, nuk po i mbroj asnjë interes të asnjë kompanie, ajo tokë vlerësohet dhjetë fish më shumë. Nesër pasnesër bëhet shpronësimi dhe janë kërkesa shumë më të mëdha se sa para se më fillua punimet.

Kuvendi me 23 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, miratoi rendin e ditës për këtë mbledhje, pa ndryshime.

Në procedurën e votimit nuk mori pjesë: Zenel Shatri, Haki Podrimaj dhe Radoš Repanović.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi, njoftoi se për këtë mbledhje mungon Radoš Repanović dhe Jehonë Haxhiaj. Gjithsej në mbledhje ishin të pranishëm 25 (njëzetë e pesë) këshilltarë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, vazhdon me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka lidhur me këtë procesverbal? Nëse jo atëherë

unë kam, një përmirësim teknik në pjesën ku shënohen emrat e këshilltarëve prezent nuk është emri i një këshilltari që ka qenë prezent.

Kuvendi në mënyrë unanime miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Zenel Shatri, Haki Podrimaj dhe Radoš Repanović.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi, vazhdon me pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2019. Bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, rregulloren e punës dhe statutit të komunës, kemi hartuar Raportin e punës së KK-së. E përcjelli fjalën të anëtarët e KK-së lidhur me këtë raport.

Agron Avdiaj, përshëndeti të pranishmit. Lidhur me këtë raport kam shkoqitur dy, tri çështje që është më rëndësi me i përmend. Po filloj me një çështje teknike më shumë, ku në raport thuhet se janë marrë gjashtëdhjetë e tetë vendime të ndryshme si dhe tetë rregullore ndërsa më shkronja brenda kllapave është tri dhe nuk po e dimë se a janë tetë apo tri? Konsideroj se kur flasim për vendimet apo rregulloret që janë miratuar gjatë kësaj periudhe, që i referohet raportit kish qenë mirë që si sfidë që në rastin e prezantimeve të vendimeve të ndryshme dhe rregulloreve, kemi pasur nganjëherë vështirësi, paqartësi unë dhe kolegët. Kemi rënë në lajthitje dhe nuk dinim se çka me votu, në aspektin e sqarimeve. Konstatimi im që është shqetësues për ne si anëtar të kuvendit është se asnjë pyetje nuk është bërë më shkrim nga ana e anëtarëve të kuvendit. Edhe pse unë kam bërë pyetje dhe është mirë kur një përgjigje bëhet më shkrim të kthehet më shkrim. Me shkrim e konsideroj edhe kur dërgoi email. Raporti konstaton se nuk është bërë asnjë pyetje me shkrim. Me duket shumë inkurajuese se ka pasur vetëm dymbëdhjetë mungesa nga anëtarët e kuvendit. Përshtypja ime ka qenë së ka pasur më shumë mungesa. Raporti po ashtu konstaton se kryetari ka qenë prezent po thuaj në të gjitha mbledhjet nuk isha pajtuar. Drejtorët kanë marr pjesë por nga fundi i seancave kanë dalë. Këto më shumë i kam si sugjerime dhe jo si kundërshtime.

Kryesuesi, po pajtohem lidhur me ato që the kemi pasur dilema në raste të caktuara, për mungesa ashtu është sepse ka raste janë nënshkruar në fillim të mbledhjes dhe pastaj kanë dalë. Kryetari ka qenë prezent shumicën e herëve edhe nëse nuk ka qenë ka marr pjesë çdo herë Nënkryetari.

Kryetari, është e vërtetë që rregullisht nuk kam marr pjesë por është tepër e rëndësishme që nuk i kam bojkotuar mbledhjet asnjëherë. Mos prezenca është për një arsye, ka ndodhë se kam pasur një takim dhe krahasim me rendin e ditës e kam parë të rëndësishme që të rrijë në takim. Unë i respektoj këshilltarët komunal sepse edhe ju jeni të votuar nga populli ashtu sikur unë. Nuk ka asnjë arsye tjetër.

Zenel Shatri, përshëndeti të pranishmit. Konstatimi i Kryetarit qëndron por unë kam një shqetësim që edhe më herët e kam thënë që drejtorët mungojnë shumë. Pjesën e dytë të mbledhjes jemi të gjithë këtu prezent, asnjë nuk rrinë këtu. Unë po jap vërejtje dhe sugjerime dhe tash e tutje të qëndrojnë këtu.

Arben Kabashi, vërejtjet janë të ngjashme. Desha të lidhem më piken e pyetjeve. Përderisa e kemi pikë të rendit të ditës atëherë nuk kemi nevojë që me shkrim me adresu për të bërë pyetje. Te mungesat pajtohem me parafolësit. Unë kam një vërejtje të komisioni për punë të kuvendit, në vitin 2018 është planifikuar plani i punës për vitin 2019, kanë qenë edhe shtatë pika të parapara që nuk janë cek në këtë raport dhe kisha kërkuar që ato të futën.

Kryesuesi, sa i përket pyetjeve është e vërtetë që mund t'i bëjmë në pikën e rendit të ditës por përgjigja e tyre nuk e ka efektin sepse shumë herë po bëni pyetje aty për aty dhe nuk mund të jepen shumë të dhëna. Sa i përket mungesave besojë qytetarët do ta jepen vlerësimin më vonë. Pikat e rendit të ditës kemi pas por nuk janë miratuar. Fjalën ja kaloi Ajshe Metajt.

Ajshe Metaj, përshëndeti të pranishmit. Unë desha të lidhem më një çështje që edhe u fol nga parafolësit lidhur me mungesat. Pak a shumë desha të dijë se ato mungesa a janë të arsyeshme apo të paarsyeshme. Dhe propozoj që lista e nënshkrimeve të jetë në fund të mbledhjes. Për vetë faktin se po vijnë po në nënshkruhen dhe po dalin e ne po barazohemi me ata. Po ashtu kam vërejtje në rregullore për bursa që të përmirësohet. Dëgjimet publike që behën në komunë nuk ka pjesëmarrje të qytetarëve dhe desha të dijë se çka duhet të bëjmë që të rritet ky interesim se dihet sa është i rëndësishëm kontributi i tyre. Duhet të punojmë që të rritet pjesëmarrja e qytetarëve.

Kryesuesi, pasi që nuk ka diskutime tjera, ishin disa fjali që në raportin e ardhshëm do t'i kemi parasysh dhe ja vlen që u thanë. Pasi që nuk ka diskutime tjera po vazhdojmë.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi, vazhdon me pikën e katërt të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të punës së KKSB-së për vitin 2020, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ja kaloi Lavdije Bujupit.

Lavdije Bujupi, përshëndeti të pranishmit. Sa i përket raportit në fjalë, raporti është i punuar mirë pa ndonjë vërejtje, në raport janë përfshirë të gjitha fushat: arsim, shëndetësi të gjitha me radhë. Mirëpo kisha dashur me u ndal të çështja e trajtimit të qeneve endacak, që është një temë mjaftë e ndjeshme dhe shumë e rëndësishme me u trajtu. Në bazë të raport shihet qartë se mundësia dhe nuk ka ndonjë plan të detajuar për trajtimin e qeneve endacak. Megjithatë në raport që komuna komfort ligjit ka mundësi dhe ka të drejtë që më mjete vetanake të merret më problemet e trajtimit të

geneve endacak. Pyetja ime është për Kryetarin, sa kemi mundësi si komunë të merrem më këtë çështje mjaft të ndjeshme pasi që shihet se edhe numri i tyre është në rritje. Në raport thuhet se janë trajtuar 224 qenë endacakë për vitin 2017 dhe 2018. Është problem serioz dhe duhet që të trajtohet me kohë dhe jemi të rrezikuar si ne ashtu fëmijët e të gjithë.

Kryesuesi, është trajtu kjo temë edhe në KKSB. Kryetari e ka fjalën.

Kryetari, ky është një problem dhe është trajtuar disa here. Ka ndodhur një periudhë që kemi pasur përkrahje donacione dhe ka funksionuar mirë. Qeveria e pati marr përsipër që të merret por nuk funksioni dhe u rritë numri prapë. Janë trajtuar një kohë dhe ka qenë vendi i caktuar dhe po pajtohem se është problem alarmant dhe shqetësues. Duhet të bëjmë ç'mos po presim edhe qeverinë nëse formohet dhe shohim se duhet të merremi patjetër. Me decenie po merrem e këtë problem dhe nuk ka sukses. Unë mendoj që në fund të fundit të heqim një projekt dhe të trajtojmë këtë problem.

Labiot Aliaj, unë desha të ndërlidhem të raporti i z.Haxhi Iberdemaj, Udhëheqës i Qendrës Regjionale të Shërbimeve Sprovuese në Pejë. Në raportin e tij të gjitha statistikave janë për vitin 2018. A është gabim teknik gjatë shënimit të procesverbalit dhe duhet 2019.

Kryesuesi, besoj është një gabim teknik dhe fjala është për vitin 2019.

Eljot Kukiqi, përshëndeti të pranishmit. Vetëm desha të pyes të projekti numër gjashtë, shënon kodi, ambienti dhe deponitë ilegale dhe shënon përshkrim nga Drejtoria e Inspeksionit, Ambientit. Ndërsa përshkrimi është i zbrazët, a ka ndodhur ndonjë gabim?

Kryesuesi, është e mundur që nuk është trajtuar si pikë e rendit të ditës. Përndryshe do ta marrësh përgjigjen nga përpiluesi.

Arben Kabashi, kur jemi të KKSB-ja janë marr shumë iniciativa nga ky këshill. Të parkingut afër shkollave është shqetësim edhe i nxënësve dhe i prindërve mungesa e parkingut. Te shkolla: "Martin Camaj" në Gjurakoc, është një rrezikshmëri për shkak të bartjes së nxënësve që po i dërgojnë prindërit. Është rrezik për të gjithë aty edhe për këmbësorët dhe unë e kisha ndryshuar aty, një pjesë e kisha caktuar për parking. Vërejtje e prindërve është të krijohet një parking. Në raport janë të cekura dy raste në vitin 2019, që kemi substanca narkotike. Unë ju besoj dokumenteve por kisha kërku nga ky komision të jenë më afër shkollave të Gurrakocit. Gjithashtu e kam përshëndet vendimin e kryetarit për rrënimin e objekteve të vjetra. Marrë shembull se pari Gurrakocin, janë njerëz që vijnë edhe nga komunat tjera dhe i shfrytëzojnë ato objekte që të përdoren substanca narkotike dhe mos të flas për anën e amoralitetit. Unë desha

të përshëndes këtë raport, është i detajuar në përgjithësi si KKSB kërkojmë të jetë edhe më aktiv dhe t'i sjell KK-së propozime.

Kryetari, pikërisht iniciativa të vjetra sidomos të ish burgu i Gurrakocit, ka qenë i KKSB-së përkatësisht i Komandantit të Policisë. Duke e ditë që për rrënimin e saj është marr vendimi. Aty janë banorë që janë më shumë nga komuna tjera, më shumë nga Komuna e Klinës. Duhet të behët një zgjidhje sepse nuk mund t'i qesim në rrugë. Kam biseduar më Kryetarin e Klinës dhe t'i sigurojë ose t'i fus në listë për ndërtimin e shtëpive. Aty ka gjithçka dhe gjithsesi së ai objekt do të rrënohet është kërkesë e KKSB-së dhe do të jetë edhe nga ju si KK.

Ajshe Metaj, edhe unë desha të ndërlidhem më këtë pikë. Sidomos me abuzimin me fëmije dhe adoleshent me një theks të veçantë të shpërndarja e narkotikëve. Sipas disa statistikave në raport po thotë se nuk ka shpërndarës të substancave narkotike por megjithatë është mjaftë shqetësuese së a është paraqitur një raport i saktë apo jo. Policia menaxhon bukur mirë por po flas për mosha më të reja po vijnë nga shkolla fillore që po vijnë në gjendje shqetësuese. Unë si mësimdhënëse kisha thënë që fëmijët të mos largohen nga ora mësimorë në mënyrë që të vijë deri të hapësira të bijë në kontakt me substanca narkotike. Kisha apeli që të punojmë në drejtim që të shpëtojmë këtë rini kaq të bukur që e kemi.

Labinot Aliaj, unë desha të ndërlidhem të raporti i bujqësisë z. Beqir Metaj. I cili Bjeshkët e Istogut atë të Lugu i Butë dhe të Radushës. Kur flet për Lugun e Butë z. Metaj thotë se 99% është gjendje e mirë që do të thotë një arritje shumë e mirë në mbrojtjen e asaj pjesë. Ndërsa kur flet për pjesën e Radushës nuk jep statistikë është dashur edhe për këtë pjesë të jap një përqindje se si është gjendja? Kisha kërku që edhe këtu të jepet një raport me përqindje.

Kryesuesi, Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së ka ardhur por pasi që nuk kemi diskutime tjera po e përmbyllim këtë pikë të rendit të ditës më kaq.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi, vazhdon me pikën e pestë: Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019. Para se të hapim debatin fjalën ia kaloj Kryetarit.

Kryetari, është mjaft voluminoz ky raport dhe unë jam këtu. Jam i gatshëm që të ju përgjigjem, e di ka defekte jo në raport por natyrisht ka mungesë të angazhimit të duhur për kryerjen e punëve. Nuk mund të them se jam i lumtur shumë për punën në vitin 2019 por as nuk jam i zhgënjyer. Ka vend për përmirësime, ka vend për rritje të efikasitetit dhe angazhimit më të fuqishëm gjatë punës. Jeni ju ata që mund ta vlerësoni dhe të jepni sugjerime dhe vërejtjet e juaja. Për mos sukses të organeve ekzekutive një pjesë ju takon edhe juve. Ne kërkojmë edhe përkrahje nga ju dhe miratimin e propozimeve. Nuk dua të shpërndaj përgjegjësinë por një bashkëpunim

më i mirë dhe më i fuqishëm tani po e shndërroj edhe në apel. Natyrisht ka forca të ndryshme politike dhe ka fërkime, tensione por nuk dëshiroj të këtë fyerje dhe përçarje në ekstrem. Shohim se çka do të bëjmë këtë vit, vonesat e qeverisë do t'i vuajmë në fund vit jeni të bindur. Ne kemi pasur vonesa në shumë projekte në vitin e kaluar, nuk kemi qenë shumë efikas por ka pasur edhe vonesa për arsye tjera që janë edhe objektive dhe të brendshme. Këtu i kemi drejtorët dhe mund të japin sqarime.

Ajshe Metaj, unë i përkas fushës së arsimit dhe kisha kërku një elaburim për një projekt që ka të bëjë më pajisjen e bibliotekës më libra në vlerë prej 5000 euro. Ky projekt është implementu por unë kam vërejtjet e mia si në shkollë ashtu edhe këtu. Për vet faktin që lista e titujve të propozohet nga ana e mësimdhënësve nga lëndët përkatëse më atë nuk korrespondon fare. Arsimi i mesëm është arsim para universitar dhe kam kërkuar nga këtu të ofrohen disa tituj që do të ju nevojiten nxënësve para se të shkojnë në fakultet. Nga ana tjetër titujt kanë ndryshu dhe kisha dashtë të dijë nga kush dhe ku është bërë ndryshimi. Në bibliotekë kanë ardhur shumica që është kërkuar një dhe kanë ardhur dhjetë ose është kërkuar një fjalor kanë ardhur dhjetë, janë shumëzuar titujt ndërsa titujt që ne i kemi kërkuar nuk janë.

Kryesuesi, nuk kam përgjigje për këtë sepse as nuk e kam bërë listën dhe as nuk e kam ndërruar. Përgjigjen të jep drejtori, nëse nuk e ka ky të thotë propozuesi. Nuk është hera e parë që ka ndodhur.

Hajrush Shoshi, përshëndeti të pranishmit dhe sa i përket titujve të librave kanë ardhur nga lista e shkollës dhe asnjë ndryshim nuk është bërë. Në tender kanë qenë në bazë të njësive. Andaj kjo është kërkesë e drejtorit të shkollës.

Ajshe Metaj, unë kam listën e propozimeve që e kanë bërë dhe listën që e kemi kërkuar. Ne nuk ka nevojiten dhjetë kanune në bibliotekë dhe ka shumë ndryshime dhe mua më interesoi kush e ka ndryshu.

Agron Avdiaj, unë mendoj se në raport këtu me fol për secilin projekt na shkon kohë shumë. Unë pajtona me Ajshen do të thotë me shqetësimin e saj por raporti i kryetarit do të thotë pak ma gjeneral si në tërësi me i kap dhe me i bere krahasimet me vitin e kaluar për me qenë më efikas trajtimi i tij. Nëse hymë më projekte ka shumë mangësi dhe kam përshtypjen se ka më na morë shumë kohë.

Arben Kabashi, unë e kam problem se raportin e punës e përcjelli ma shumë gjatë fushatës elektorale dhe pajtona me kryetarin se nuk i kemi lexu në detale. Si vërejtje ka qenë mos prezenca e kryetarit dhe komisioneve në implementim të projekteve ose në kryerjen e projekteve kapitale. Ka implementime që nuk jemi të kënaqur as ne si qytetarë. Prezenca e kryetarit kish sjellë që puna në realitet të jetë më e suksesshme. Nuk dua të hyjë në detale por shpesh herë mbikëqyrja e punëve po behët shkel e shko. Janë një pjesë e madhe që nuk jemi të kënaqur, ka edhe punë që janë kryer mirë por vërejtja imë ka qenë që prezenca e kryetarit dhe e këshilltarëve të jetë më e dukshme.

Kur jemi të raporti i punës së kryetarit do ishte mirë që këshilltarët të jenë më shumë në teren. Si shembull e kemi Tomocin që kemi kacafytje lidhur me projekt. Përndryshe është raport i detajuar shumë mirë.

Slavisha Malikovic, përshëndeti të pranishmit. Projekti i kanalizimit në fshatin Serbobran, si te ishte problemi në lidhje me Bashkësinë Evropiane, vetëm të ju sqaroj se ky kanalizim është bërë vetëm për komunitetin Egjiptian, Rom e kështu me radhë. Kështu që asnjë familje malazeze nuk janë kyçur në këtë kanalizim, kështu që unë kërkoj që edhe neve të na mundësohet kyçja në këtë kanalizim, po ashtu kam edhe një pyetje apo sqarim, si mundet me qenë prioritet ndërtimi i trotuarit Veriq – Bellopijë, e të mos jetë prioritet trotuari Gjurakoc – Serbobran – Kovragë?

Kryetari, sa i përket trotuarit unë nuk mund të them pse është ajo prioritet e pse kjo jo. Mirëpo që duhet të bëhet kjo për Serbobran sigurisht ne e kemi mëndur me vazhdu nga Gjurakoci por po duhen më shumë mjete. Ajo ka qenë çështja e shkollës sepse ke te drejtë, ne i kemi shty më shumë ka pjesa jugore por do të vazhdojmë.

Hysni Maxharri, përshëndeti të pranishmit. Sa i përket pyetjes së Slavishes, projekti me participim dhe bashkëpunim me Zyrën Evropiane është në Zyrën Lokale për Komunitete dhe ai projekt nuk është implemtu ende sepse mjetet janë alokuar në fund të vitit. Mjetet tona që kanë qenë të parapara për participim kanë qenë të zotuar por nuk janë shpenzuar ndërsa mjetet e BE -së janë alokuar në fund që ka mbet që ai projekt të bëhet këtë vit.

Labinot Aliaj, unë vetëm desha të sigurojë kryetarin se e kam lexuar më vëmendje raportin të gjitha faqet. Janë disa gjera që janë faktike dhe janë përshkru por desha të përgëzoj zyrën e tij që për dallim nga raporti i kryesuesit të KK-së ka më pak gabime gjuhësore.

Eliot Kukiqi, unë desha të ndalem në raport, të auditori i brendshëm. Do të thotë nga raporti i auditimit janë dhënë njëzetë e pesë rekomandime të ndryshme lidhur me të gjeturat. A janë rekomandime të brendshme dhe cilat janë ato?

Kryesuesi, po e kemi edhe auditimin e brendshëm.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi, vazhdon me pikën e gjashtë të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, Tetor-Dhjetor 2019.

Osman Sadikaj, Zyrtar kryesor financiar përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetorë 2019.

Kryesuesi, do ta kemi edhe raportin vjetor, unë ua kaloi fjalën nëse e dëshiron dikush?

Eliot Kukiqi, gjatë analizës së këtij raporti më ra në sy se shumica e shpenzimeve janë kryer në tetor-dhjetorë. Nga burimet e financimit në TM4 janë shpenzuar 3 milion e 953 mijë e 151 euro apo 41.9% e të hyrave e totalit të burimit të financimit. Çka shihet se vetëm në TM4 janë shpenzuar sa gjysma e gjithë vitit. Te shpenzimet kapitale në TM4 janë shpenzuar 1 milion e 3 qind e 2 mijë e 627 apo 60.8% e mjeteve të planifikuara të shpenzimeve kapitale. Në gjithë vitin shpenzimet kapitale janë shpenzuar 1 milion e 892 mijë e 569 apo 89% e shpenzimeve kapitale. Çka për mua është shqetësuese se gjatë 9 muajve kemi shpenzuar vetëm 27% ndërsa për tre muajt e fundit 60.8 %. A janë përfunduar punimet e këtyre projekteve në mënyrën më të mirë të mundshme apo vetëm sa për të shpenzuar këto mjete? Sa po e shohë unë në fund të vitit po shpenzohet shumë më shumë. Kërkoj që vitin tjetër të fillohet më herët me kapitale. Te të hyrat vetanake qëndrojmë mirë 95.6%.

Arben Kabashi, kam dy pyetje. E para kemi mbi 300 mijë euro që shkojnë suficit, tash mungesa e mos planifikimit mirë të projekteve dhe e dyta, 30% kanë qenë të realizuara deri në muajin shtatorë do të thotë 70% të mjeteve janë realizuar në tre mujorin e fundit? A janë planifikuar që të realizohen në tre mujorin e fundit apo gjashtë mujorin e parë?

Kryetari, ka plotësisht të drejtë Elioti dhe është një fakt dhe kështu ka ndodhur edhe ajo nga mbetjet e projekteve është rezultat i mos angazhimit të mëhershëm sepse kemi pasur mundësi me i ridestinu. Janë menaxhuar por kanë dalë si mbetje. Më këtë ligj të financave dhe prokurimit do të ndodhë edhe në të ardhmen. Nuk është faji vetëm të ligji por edhe tek ne. Konkurrenca në treg është bukur e rend dhe e pandershme. Kjo është e vërtetë edhe atë që e tha Arbeni, kjo është realiteti.

Agron Avdiaj, mirë me thënë të drejtën kur Kryetari po i pranon gabimet e këto sikur e ka gjetur si strategji dhe po funksionon edhe me ne anëtarët e kuvendit. Kur po thotë kjo është keq dhe po e pranon. Ideja është se në nuk po kërkojmë perfeksione se as vetë nuk jam i tillë por kur dikush më jep kritikë herën tjetër më një përqindje të vogël me qenë pak më mirë se para kritikës. Kjo është edhe insistimi jonë. Unë kërkoj edhe nga kolegët tjerë sikur po pajtohen për gjithçka dhe problemi është se kur doket gjithçka mirë diçka nuk është në rregull. Mundeni të jeni edhe më efikas edhe drejtorët edhe kryetari edhe ne. Konsideroj se nuk e kemi presionin e mjaftueshëm si kuvend. Mundemi me përmirësu sado pak gjendjen.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi, po vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës: Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal. Kemi pasur një kërkesë nga Misin Berisha, ka kërkuar më shkrim të merë përgjigje. Unë sa jam në dijeni e keni marr këtë përgjigje, i nderuar anëtar i kuvendit.

Misin Berisha, përshëndeti të pranishmit. Përgjigjen e kam marrur nga drejtori dhe me herët bisedova me drejtorin dhe me premtoi se do vjen personalisht. Faleminderit për përgjigjen.

Kryesuesi, pyetja ka qenë e hapur dhe e ka marrë drejtori e ka kthyer me shkrim nëse anëtarët e kuvendit janë të interesuar përgjigjja me shkrim që e ka dhënë drejtori për anëtarin e kuvendit mund ta lexon. Fjalën ja kaloi Labinot Aliajt.

Labinot Aliaj, kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit. Komisioni për ankesa për ndarjen e bursave a kanë marr pjesë në shqyrtim të ankesave të gjithë anëtarët e komisionit nga kuvendi nga shoqëria civile dhe sa ankesa janë aprovu?

Kryesuesi, jam në dijeni që komisioni janë taku dhe kanë mbajtur mbledhje. Fjalën ja kaloi drejtorit.

Hajrush Shoshi, komisioni ka mbajtur takimet dhe ka shqyrtuar ankesat dhe tri ankesa janë aprovuar.

Riza Dreshaj, përshëndetje për të gjithë, unë kam qenë kryetar i komisionit për ankesa. Kanë qenë gjithsej 16 ankesa. Në komision kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët dhe në bisedime me drejtorin e drejtorisë ka qenë mundësia që të nxjerrën edhe tre bursistë dhe janë nxjerr edhe tre bursistë.

Labinot Aliaj, unë përgjigjen e mora por unë sipas Kryesuesit të komisionit, do të thotë nuk ka shkelje në vlerësimin që është bërë për 38 studentët dhe komisioni për ankesa që më të drejtë në bazë të rregullores, ka drejtë vetëm përgjigje me shkrim dhe për ata të cilët janë ankuar ka ndarë bursa. Të jemi të qartë.

Kryesuesi, duke ju falënderuar për pjesëmarrje në këtë takim dhe kontributin e dhënë i shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në orën 12:00.

Procesmbajtëse,
znj. Arlinda Kurtaj



Kryesuesi i Kuvendit,
Z. Qaush Balaj

